



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË



Sheshi "Skënderbej", No. 1, Tirana - Albania • **Tel:** ++355 4 222230; 222750; 235568
• **Fax:** ++355 4 223558 • **Website** www.bankofalbania.org • **E-mail:** public@bankofalbania.org

DEKLARATË PËR SHTYP

ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR TREMUEJORIN E PARË TË VITIT 2005

Qershor 2005

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për vitin 2004 rezultoi me një tepricë prej 12.7 milionë usd. Flukset hyrëse të kapitalit kanë qenë të mjaftueshme për të përbaluar nivelin e deficitit korent.

Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm të ekonomisë shqiptare mund t'i përgjithësojmë në:

- Aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm, i shprehur në rritje të konsiderueshme të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente.
- Rritje të deficitit korent, në krahasim¹ me një vit më parë.
- Rritje e pretendimeve të vendit ndaj jorezidentëve, e shprehur kryesisht në rritje të investimeve të portofolit me jashtë.
- Rënie e nivelit të huamarrjes shtetërore dhe private, në krahasim me një vit më parë.
- Rritje në stokun e rezervave valutore të autoritetit monetar si dhe e koeficientit të mjaftueshmërisë së rezervave valutore për importe mallrash dhe shërbimesh.
- Zhvlerësim i dollarit amerikan si ndaj monedhës evropiane, ashtu edhe ndaj lekut. Efekti i zhvlerësimit të dollarit duhet të merret parasysh sidomos në transaksionet e kryera në monedha të tjera (euro). Kështu, deficitit tregtar i matur në euro, gjatë këtij tremujori, rezulton 9 për qind më i lartë sesa ai i vitit të kaluar, ndërsa i matur në usd deficitit është thelluar me rreth 16 për qind.

¹ Të gjitha krahasimet bëhen me tremujorin e parë të vitit 2004.

I. Llogaria korente

Transaksionet korente, të zhvilluara gjatë tremujorit të parë të vitit 2005, vlerësohen në rreth 1.7 miliardë usd ose 26 për qind më të larta se në vitin paraardhës. Shkëmbimet tregtare në mallra dhe shërbime kryesojnë vëllimin e transaksioneve korente të Shqipërisë me botën. Mëse 95 për qind e shpenzimeve kanë shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh. Rreth 41 për qind e të ardhurave kanë hyrë në formën e transfertave korente, ndërkohë që shërbimet dhe eksportet e mallrave siguruan përkatësisht 33 për qind dhe 20 për qind të të ardhurave. Të ardhurat faktoriale neto janë rritur me rreth 32 për qind krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2004, megjithatë nuk kanë mundur të zbusin deficitin e lartë tregtar (mallra dhe shërbime). Ky i fundit është rritur ndjeshëm ndaj vitit të kaluar (rreth 31 për qind) ndikuar nga pozicioni deficit i shërbimeve si dhe nga thellimit të deficitit që shoqëron aktivitetin e tregtisë së jashtme në mallra. Si rezultat i këtyre lëvizjeve, llogaria korente u mbyll me një deficit prej 56 milionë usd, me rritje vjetore prej rreth 23 për qind.

I. 1. Tregtia e jashtme.

Zhvillimet në tregtinë e jashtme flasin për tendenca në rritje të vëllimit të përgjithshëm tregtar, i cili arriti nivelin 680 milionë usd dhe vlerësohet 15 për qind më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Shkëmbimet tregtare në mallra përfaqësuan rreth 41 për qind të vëllimit të transaksioneve korente. Ekonomia shqiptare dhe tregu i brendshëm mbeten të orientuar drejt importit, i cili gjatë këtij tremujori ishte rreth 3 herë më i lartë se eksporti. Kërkesa e brendshme vazhdoi të nxiste rritjen e importeve, ndërkohë që ecuria pozitive e eksporteve nuk ka mjaftuar për të ngushtuar deficitin tregtar. Shpenzimet për importe shënuan afërsisht vlerën 521 milionë usd ose rreth 67 milionë usd më shumë, krahasuar me vitin 2004. Të ardhurat nga eksporti i mallrave u rritën me 16 për qind, duke arritur në 159 milionë dollarë.

Deficiti tregtar, në mbyllje të tremujorit, ishte 363 milionë usd ose 14 për qind më i lartë sesa ai i periudhës korresponduese të vitit paraardhës. Deficiti i lartë dhe rregullisht në rritje i tregtisë së jashtme tërheq vëmendjen drejt politikave që synojnë zëvendësimin e importeve dhe nxitjen e eksporteve.

Struktura e importeve dominohet prej mallrave të ndërmjetëm, të cilët gjatë këtij tremujori përfaqësuan rreth 46 për qind të totalit të importeve. Vëllimi në rritje i këtyre të fundit flet për ecuri pozitive të industrisë së përpunimit në vend. Gjithashtu, pozitivisht vlerësohet ecuria e mallrave kapitalë, si një tregues optimist për nivelin e investimeve, për rinovimin e bazës teknologjike si dhe të produktivitetit të sektorit privat. Vërejmë që, kategoria e mallrave të konsumit vazhdon të ruajë një peshë të konsiderueshme në importet totale, rreth 32 për qind.

Kontributin kryesor në rritjen e eksporteve shqiptare e kanë dhënë riekportet (eksporte me material porositësi), të cilat vazhdojnë të jenë dominuese në eksportet shqiptare, duke zënë aktualisht 81 për qind të vëllimit të përgjithshëm

të tyre. Të ardhurat nga eksportet e kësaj kategorie vlerësohen 16 për qind më të larta kundrejt tremujorit të parë të vitit të kaluar.

I. 2. Zhvillimet në zërat e tjerë të llogarisë korente.

Tregtia në shërbime është shndërruar në një element të rëndësishëm të integritit global. Transaksionet tregtare në shërbime, gjatë këtij tremujori arritën në rreth 566 milionë usd dhe vlerësohen 32 për qind më të larta krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2004. Përshpejtimi i aktivitetit ekonomik në sektorin e shërbimeve të ofruara dhe/apo të kërkuara jorezidentëve, përbën një tregues pozitiv në ecurinë e hapjes dhe të integritit të ekonomisë shqiptare në tregjet ndërkombëtare. Llogaria e shërbimeve për tremujorin e parë të vitit 2005 u mbyll me një bilanc negativ prej 37 milionë dollarësh, ndryshe nga ecuria në periudhën korresponduese të vitit të kaluar që rezultoi me suficit prej 12 milionë usd. Deficiti i këtij fillim viti ka ardhur kryesisht si pasojë e ngushtimit të suficitit të zërit “udhëtime” dhe e ndryshimit të kahut të bilancit në “shërbimet e tjera”.

Lëvizjet në llogarinë e shërbimeve influencohen ndjeshëm nga zhvillimet në shërbime për “turizëm” (udhëtime). Aktualisht, aktiviteti i turizmit përfaqëson një nga burimet kryesore të të ardhurave në valutë për ekonominë shqiptare. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, eksporti në turizëm, gjatë tremujorit të parë të vitit 2005 ka gjeneruar rreth 196 milionë usd flukse të ardhurash, një vlerë kjo rreth 24 për qind më e lartë se vlera e eksporteve të mallrave. Rritja vjetore e të ardhurave nga turizmi është influencuar kryesisht nga rritja e numrit të shtetasve të huaj dhe e emigrantëve që kanë vizituar vendin, si edhe nga rritja e lehtë e shpenzimeve të tyre ditore. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2005, numri i shtetasve të huaj që kanë vizituar Shqipërinë është rritur me 15 për qind, në krahasim me të njëjtën periudhë në vitin e kaluar. Aktiviteti i përshpejtuar vërehet në kahun e shpenzimeve për turizëm, të cilat vitet e fundit kanë shfaqur norma vjetore rritjeje më të larta. Rezidentët shqiptarë kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë shtetit rreth 189 milionë usd ose sa 74 për qind e totalit të dërgesave nga emigrantët. Shqiptarët shpenzojnë më shumë për qëllime personale, kategori e cila ka regjistruar një rritje prej rreth 67 për qind, kundrejt tremujorit të parë të vitit 2004. Rritja në shpenzimet e udhëtarëve shqiptarë jashtë është dukshëm më e lartë sesa rritja në të ardhura, duke shkaktuar ngushtimin e bilancit pozitiv të kësaj kategorie në 7 nga 33 milionë usd në tremujorin e parë të vitit 2005.

Kategoria “shërbime të tjera” rezulton me deficit prej 13 milionë dollarësh, ndryshe nga suficiti (8 milionë usd) në tremujorin e vitit 2004. Gjatë këtij tremujori janë rritur ndjeshëm shpenzimet në kategoritë “shërbime kulturore dhe biznesi” si dhe në “asistencë teknike”. Ndërkohë që, të ardhurat që gjenerohen nga shërbimet e telekomunikacionit vazhdojnë të kenë ecuri pozitive, duke çuar në rritje të suficiteve të kësaj kategorie. Këtë tremujor bilanci pozitiv i “shërbimeve të telekomunikacionit” vlerësohet 4 milionë usd më i lartë krahasuar me vitin e kaluar.

Llogaria e të ardhurave është mbyllur me një bilanc pozitiv prej 46 milionë dollarësh, duke shënuar një rritje prej 24 për qind krahasuar me tremujorin e parë 2004. Rritja më e madhe në hyrjet (kredi) e kësaj llogarie është regjistruar në “kompensimin e punonjësve”. Të ardhurat nga kompensimi i punonjësve rezidentë të punësuar sezonalisht jashtë Shqipërisë janë vlerësuar në 29 milionë usd, me rritje vjetore prer rreth 26 për qind. Të ardhurat nga interesat e rrjedhura prej investimit të rezervës valutore vlerësohen në rritje, ndërkohë që interesat mbi investimet e portofolit të rezidentëve jashtë kanë rënë konsiderueshëm (rreth 2 herë). Shqipëria gjatë këtij tremujori ka paguar rreth 3.4 milionë usd për të shlyer interesat mbi borxhin e saj të jashtëm.

Transfertat korente, ashtu si edhe gjatë viteve të kaluara, kanë marrë formë prej prurjeve nga emigrantët. Këto të fundit përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të deficitit në tregti mallrash dhe shërbimesh dhe janë vlerësuar në nivelin 255 milionë usd duke qenë 25 për qind më të larta se ato të vitit të kaluar. Megjithatë, duke pasur parasysh monedhat në të cilat kryhen këto transfertat, mund të themi se edhe në këtë zë, efekti i kursit të këmbimit është i ndjeshëm.

Prurjet nga emigrantët janë shoqëruar edhe nga transfertat shtetërore, kryesisht në formë të asistencës teknike (17 milionë usd), të cilat vlerësohen në rritje (17 për qind). Kontributi i transfertave në zbutjen e deficitit tregtar llogaritet në rreth 70 për qind.

II. Llogaria kapitale dhe financiare

Lëvizjet e kapitalit, gjatë tremujorit të parë të vitit 2005, rezultuan në një fluks neto prej rreth 66 milionë usd, duke mundësuar plotësisht financimin e deficitit korent si dhe kanë çuar në rritje të rezervave valutore. Importi i kapitalve këtë fillim viti ka ardhur në rënie (5 milionë usd) krahasuar me periudhën korresponduese të një viti më parë. Ndërkohë që, transfertat kapitale u rritën me rreth 13 milionë usd për të arritur në nivelin e 47 milionë usd, bilanci pozitiv i llogarisë financiare vlerësohet në rënie ndaj një viti më parë (me rreth 17 milionë). Pozicioni i llogarisë financiare këtë tremujor përkufizohet në rritje të detyrimeve financiare të Shqipërisë me botën (me rreth 64 milionë usd) si dhe rritje të mjeteve tona jashtë (rreth 44 milionë usd). Megjithatë, krahasuar me tremujorin e parë të vitit të kaluar, fluksi neto i detyrimeve financiare vlerësohet më i ulët, rreth 18 milionë usd. Ndërkohë, pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës kanë ruajtur të njëjtin nivel të një viti më parë.

Struktura e importeve neto të kapitalit këtë tremujor dominohet nga hyrja e kapitaleve të huaja në formën e investimeve direkte. Investimet e huaja direkte, për tremujorin e parë të vitit 2005, vlerësohen në nivelin 54 milionë usd, me një fluks tremujor rreth 19 milionë usd më shumë kundrejt të njëjtës periudhë në vitin 2004.

Faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen e detyrimeve financiare të Shqipërisë ndaj botës mbeten lëvrimet e kredive afatgjata dhe të atyre të buta nga jashtë, të cilat

e kanë shtuar borxhin e jashtëm të Shqipërisë me 22.4 milionë usd. Në këtë borxh, përfshihet edhe përdorimi i huave dhe kredive në Fond, prej 6.1 milionë usd. Ndërsa përgjatë vitit të kaluar është vënë re prezenca e sektorit privat në huamarrjen afatgjatë, këtë tremujor disbursimet e huave të këtij sektori kanë qenë shumë të ulta. Fluksi i huamarrjes gjatë këtij tremujori vlerësohet rreth 40 për qind më i ulët, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2004. Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit dhe të interesit vlerësohen në rreth 10 milionë usd, të barasvlefshme me 6.5 për qind të eksportit të mallrave.

Detyrimet financiare në formën e depozitave të jorezidentëve në sistemin tonë bankar, gjatë këtij tremujori, kanë rënë me rreth 5.8 milionë usd. Gjithashtu në rënie vlerësohet fluksi i detyrimeve në formën e kredisë tregtare (rreth 13 milionë usd).

Pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës janë rritur me 44 milionë usd, duke ruajtur të njëjtën tendencë të vërejtur në fillim të vitit të kaluar. Kjo rritje është pasojë e rritjes së fluksit të investimeve të portofolit. Stoku i mjeteve financiare në formën e investimeve të portofolit, në fund të tremujorit të parë të vitit 2005, kapi shumën 201 milionë dollarë, me një fluks tremujor në rritje prej 56 milionë dollarësh. Mjetet valutore, të zotëruara nga sistemi bankar në formën e depozitave jashtë, kanë rënë me rreth 10 milionë dollarë. Në përbërjen e depozitave të zotëruara nga sistemi bankar, 55 për qind e tyre janë në dollarë, ndërsa pjesa tjetër është në euro (41 për qind) dhe stërlina angleze (3 për qind). Gjithashtu, në rënie vlerësohen mjetet valutore *cash*. Në përbërjen strukturore sipas monedhave, mjetet valutore *cash* në dollarë amerikanë zinin 42 për qind dhe ato në euro 52 për qind, stërlina angleze 5 për qind dhe franga zviceriane 1 për qind.

Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare u reflektuan në rritje të rezervave valutore të autoritetit monetar, me rreth 13 milionë usd. Niveli i rezervave valutore bruto, në fund të periudhës, u vlerësua në 1 miliard e 350 milionë usd, i mjaftueshëm për të përballuar 4.9 muaj importe mallrash dhe shërbimesh nga 4.6 në tremujorin e parë të vitit 2004.

Bilanci i Pagesave

në milionë dollarë amerikanë

	3m-I 2004	3m-II 2004	3m-III 2004	3m-IV 2004	3m-I 2005
Llogaria korente	-45.8	-114.2	-30.8	-167.3	-56.2
Eksporti i mallrave	136.5	156.5	148.7	161.7	158.5
Importi i mallrave	-454.4	-514.6	-554.5	-671.5	-521.5
Bilanci tregtar	-317.9	-358.0	-405.8	-509.8	-362.9
Shërbimet: Kredi	220.4	248.3	273.6	261.1	264.7
Shërbimet: Debi	-208.2	-267.4	-280.0	-299.2	-301.7
Të ardhurat: Kredi	42.8	41.8	68.1	51.0	51.4
Të ardhurat: Debi	-5.3	-8.3	-6.1	-8.6	-5.0
Transferta private pashpërbim	207.8	212.9	298.9	314.3	280.2
Transferta shtetërore pashpërbim	14.6	16.7	20.4	23.9	17.1
Llogaria kapitale	34.0	25.7	35.6	37.0	46.6
Llogaria financiare	31.0	220.4	-16.4	151.8	13.4
Investime direkte	35.0	176.7	71.9	57.7	54.0
Investime portofoli	-1.3	4.0	119.8	-126.1	-56.3
Kapitale të tjera*	-2.7	39.7	-208.0	220.2	15.7
Gabime dhe harresa neto	-10.2	-14.6	101.1	39.1	2.8
Bilanci i përgjithshëm	14.9	117.4	95.3	60.6	12.7
Rezervat dhe zëra të lidhur me to					
Mjetet e rezervës	-14.9	-117.4	-95.3	-60.6	-12.7
Përdorim huash e kredish nga FMN	6.0	0.0	5.9	0.0	6.1
Për t'u mbajtur në vëmendje					
Ndryshimi total në rezerva	-2.6	-113.9	-103.2	-123.4	20.6
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimi	-12.3	-3.6	7.8	62.8	-33.3

Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë.

*/ nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN